REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 mars 2025
Nr. Ref.: AGJ 2666/25

AKTGJYKIM

në

rastin KI142/23

Parashtrues

Fadil Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në lëndën civile C.nr.655/2006 nga Gjykata Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fadil Berisha, me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ylli Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore të zhvilluara pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) përkitazi me lëndën civile [C.nr.655/2006].

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkese është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave të zhvilluara pranë Gjykatës Themelore, me pretendimin se mosvendosja për lëndën [C.nr.655/2006] nga Gjykata Themelore, cenon të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me dispozitat e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 23 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata e pranoi më 27 qershor 2023.

7. Më 13 korrik 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin [GJR.KI142/23] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare raportuese dhe me Vendimin [KSH.KI142/23] caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).

8. Më 14 korrik 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

10. Më 1 tetor 2024, Gjykata përkitazi me lëndën ia kërkoi dosjen e plotë Gjykatës Themelore.

11. Më 8 tetor 2024, Gjykata Themelore e dorëzoi dosjen e plotë të lëndës në Gjykatë dhe njoftoi Gjykatën për statusin aktual të rastit.

12. Më 9 tetor 2024, Gjykata e ktheu dosjen e lëndës së lartcekur në Gjykatën Themelore.

13. Më 26 nëntor 2024, vendimmarrja për rastin u shty për qëllime të qartësimit të kërkesës me informata shtesë.

14. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24] Gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që Gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr, më 11 dhjetor 2024.

15. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024 të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën ditë, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

16. Më 8 janar 2025, kryetari Gjykatës Nexhmi Rexhepi, nëpërmjet Vendimit GJR. KI142/23, caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues, në vend të gjyqtares Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, mandati i së cilës përfundoi, më 30 dhjetor 2024.

17. Më 12 shkurt 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë shkelje të së drejtës për nxjerrjen e një vendimi brenda një afati të arsyeshëm kohor, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve të rastit

18. Në vitin 1991, në shtëpinë e A. B. (babai i ndjerë i parashtruesit të kërkesës), kishte shpërthyer një zjarr që kishte djegur dhe shkatërruar tërësisht shtëpinë e tij. Dyshohej se zjarri ishte shkaktuar si pasojë e një avarie elektrike të ndodhur në rrjetin e tensionit të ulët.

19. Më 7 nëntor 1991, A.B. parashtroi padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Komunale) kundër ndërmarrjes publike NP "Elektrokosova" (në tekstin e mëtejmë: NP "Elektrokosova"), me kërkesë për kompensim dëmit të djegies së tërësishme të shtëpisë nga zjarri i shkaktuar nga rryma elektrike. Kjo procedurë u riaktivizua pas vitit 2000.

20. Në vitin 2006, padia, përkatësisht lënda civile në shqyrtim para Gjykatës kishte marrë numrin [C.nr.655/2006].

21. Më 25 maj 2009, A.B. parashtroi urgjencë në Gjykatën Komunale, nëpërmjet së cilës kërkoi caktimin e seancës kryesore, përkitazi me këtë rast, pasi kishte kaluar kohë nga parashtrimi i padisë së vitit 1991.

22. Siç rezulton nga shkresat e lëndës, më 12 janar 2010, Gjykata Komunale nxori aktvendim për ndërprerjen e procedurës, ndërsa më 14 maj 2010, A.B. parashtroi kërkesë në Gjykatën Komunale, për vazhdimin e procedurës së ndërprerë dhe zgjidhjen e lëndës [C. nr. 655/2006].

23. Më 1 gusht 2010, A. B., përkatësisht babai i parashtruesit të kërkesës ndërroi jetë.

24. Më 30 tetor 2013, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [T.nr.166/2010], nëpërmjet të cilit kishte shpallur trashëgimtarë legjitim të radhës së parë: (i) parashtruesin e kërkesës dhe vëllain e tij S. B., me nga 7/22 pjesë ideale të pronës; (ii) të birin Ad. B. dhe të bijat H.B., S. K. dhe F. G. me nga 2/22 pjesë ideale të pronës. Në arsyetim të Aktvendimit, Gjykata Themelore kishte theksuar: *"I ndjeri A.B., ka vdekur me dt.01.08.2010, duke mos lënë pas vetes testament, kontratë mbi ushqimin dhe mbajtjen e përjetshme apo ndonjë dëshirë të fundit, sa i përket pasurisë së patundshme e cila është masë e trashëgimisë"*.

25. Më 22 mars 2017, Gjykata Themelore nëpërmjet shënimit zyrtar [C.nr.356/16] kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës dhe paditësit tjerë se: *"Seanca e caktuar për dt. 27.03.2017, në ora 9:30 për arsye objektive (punëtori e përbashkët e Gjykatës së Apelit me Gjykatat Themelore Gjakovë, dhe Gjykatën Themelore Prizren), dhe duke pasur parasysh faktin se gjyqtari i çështjes është i zënë me lëndët tjera të caktuara më parë, atëherë seanca e radhës caktohet për dt. 16.05.2017 [...]"*.

26. Më 22 qershor 2023, Gjykata Themelore [C.nr.649/20] mbajti për herë të parë seancën e shqyrtimit përgatitor, por kjo seancë ishte anuluar me arsyetimin se nuk ishin prezent *"[...] ndërhyrësit juridik L.B dhe S.B., për të cilën Gjykata [Themelore] nuk ka prova se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt"*. Seanca e radhës u caktua të mbahej më 17 korrik 2023.

27. Më 1 tetor 2024, me qëllim të qartësimit të procedurave në lidhje me lëndën civile [C. nr. 655/2006], Gjykata ia kërkoi Gjykatës Themelore dosjen e plotë për lëndën, të cilën kjo e fundit e dorëzoi në Sekretariatin e Gjykatës më 8 tetor 2024, duke thekur se për çështjen civile në fjalë, Gjykata Themelore ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 16 tetor 2024. Gjykata nuk ka informata nëse kjo seancë është mbajtur dhe për zhvillimet e mëtejme procedurale para gjykatave të rregullta, përkitazi me këtë rast.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës në rastin në shqyrtim para Gjykatës Themelore [C.nr.655/2006], cenon të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se rasti i tij ndërlidhet me parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së për tejzgjatjen e procedurave dhe me praktikën gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht kriteret bazuar në të cilat vlerësohet tejzgjatja e procedurave, duke iu referuar praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës thekson se kjo çështje daton herët për të cilën janë caktuar gjykime në datat: 10 dhjetor 1991; 17 dhjetor 1991; 30 dhjetor 1991; 15 janar 1992; 5 shkurt 1992; 4 mars 1992; 12 janar 1997; 2 prill 1997; 9 dhjetor 1997;) 12 shkurt 1998; 8 dhjetor 1998; 28 dhjetor 1998;

19 janar 1999; 4 shkurt 1999, duke bashkëngjitur prova përkitazi me veprimet e ndërmarra para Gjykatës Themelore deri në paraqitjen e kërkesës në Gjykatë.

30. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së; si dhe (iii) që Republika e Kosovës t'ia kompensoj parashtruesit të kërkesës shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro "*në emër të dhimbjeve shpirtërore*".

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

[...]
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

31. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
> *[...]*

33. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenet: 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se rasti nuk ishte iniciuar nga vet parashtruesi i kërkesës, por nga babai i ndjerë i tij dhe ishte përcjellë nga ky i fundit deri sa A. B kishte ndërruar jetë, pastaj parashtruesi i kërkesës ishte shpallur trashëgimtar, së bashku me disa persona të tjerë, i A. B. në vitin 2013. Gjykata, përmes praktikës së saj gjyqësore dhe duke u bazuar në atë të GJEDNJ-së, ka përcaktuar se për të paraqitur kërkesë para Gjykatës një person duhet të jetë "*viktimë*" e shkeljes kushtetuese, "*direkte*" apo "*indirekte*". Gjykata ka sqaruar rast pas rasti që statusi i viktimës indirekte ose të tërthortë është po ashtu i ndërlidhur me natyrën e të drejtave që kontestohen para Gjykatës, përkatësisht nëse të drejtat përkatëse mund të cilësohen si të drejta të *"transferueshme*" apo jo. Sipas sqarimeve të dhëna përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, të drejtat që ndërlidhen me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në parim por me përjashtime, cilësohen si të drejta të *"pa transferueshme"* (shih, rastet e Gjykatës KI149/18, KI150/18, KI151/18, KI152/18, KI153/18, me parashtrues *Xhavit Aliu dhe 5 të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 korrikut 2019, paragrafët 68-73 dhe rastin e GJEDNJ-së, *Biç dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 55955/00, Aktgjykim i 2 shkurtit 2006, paragrafi 22). Megjithatë, Gjykata vëren se në ato raste kur statusi i viktimës iu ka akorduar të afërmve të afërt, duke i lejuar ata të parashtronin një kërkesë në lidhje me ankesat e tyre, përkatësisht, në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ mori parasysh faktin nëse parashtruesit mund të kishin interes material në bazë të efektit të drejtpërdrejtë në të drejtat e tyre monetare (shih, rastet e Gjykatës KI211/22 parashtrues: *IsmajI Ipshi, Bashkim Ipshi, Gjevdet Ipshi, Bekim Ipshi dhe Besim Ipshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 tetorit 2024, paragrafi 79; dhe rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 48). Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur trashëgimtar i A.B. i cili kishte paraqitur padi e që mund të kishte efekt të drejtpërdrejtë në të drejtat e tij monetare përkitazi me të drejtën e kompensimit. Prandaj, parashtruesi i kërkesës ka statusin e viktimës së shkeljeve kushtetuese. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konstaton se (i) parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesën para Gjykatës. Përkitazi me kriteret e tjera të pranueshmërisë, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës;(ii) konteston tejzgjatjen e procedurave të zhvilluara pranë Gjykatës Themelore dhe ka saktësuar shkeljet e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, dhe në këtë mënyrë ka qartësuar kërkesën e tij në përputhje me nenin 48 të Ligjit.

35. Për më tepër, Gjykata duhet të vlerësojë gjithashtu, nëse kërkesa përmbush kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, që përcakton:

Neni 49
(Afati)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

36. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston tejzgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore, për mosvendosje në kohë të lëndës civile [C. nr. 655/06], e cila ende nuk ka përfunduar pranë kësaj të fundit. Gjykata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht tejzgjatjen e procedurës pranë kësaj instance gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej katër (4) muajve.

37. Përveç kritereve të përcaktuara në Ligj, Gjykata shqyrton tutje nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
(...)
(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

38. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara nëpërmjet paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.

39. Për më tepër dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

40. Gjykata fillimisht rikujton se në vitin 1991, në shtëpinë e A.B. (babai i ndjerë i parashtruesit të kërkesës), kishte shpërthyer një zjarr që kishte djegur dhe shkatërruar tërësisht shtëpinë e tij. Dyshohej se zjarri ishte shkaktuar si pasojë e një avarie elektrike të ndodhur në rrjetin e tensionit të ulët. Si pasojë, më 7 nëntor 1991, A.B. kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale, për të cilën janë mbajtur disa seanca shqyrtuese, por pa ndonjë vendim për çështjen. Padia ishte riaktivizuar pas vitit 2000. Në ndërkohë, lënda civile sipas kërkesëpadisë kishte regjistruar me numrin [C.nr.655/2006], për të cilën A.B., më 25 maj 2009, kishte dorëzuar një urgjencë në Gjykatën Komunale, për caktimin e seancës kryesore, pasi kishte kaluar kohë nga inicimi i padisë pa ndonjë seancë të mbajtur. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata Komunale, më 12 janar 2010 kishte ndërprerë procedurën, megjithatë, pas njoftimit për ndërprerje të procedurës, A.B., më 14 maj 2010, kishte kërkuar nga Gjykata Komunale vazhdimin e procedurës dhe shqyrtimin e lëndës në pritje. Më 30 tetor 2013, pasi që A. B. kishte ndërruar jetë në gusht 2010, Gjykata Themelore, me Aktvendimin [T.nr.166/2010], shpalli trashëgimtarë legjitim të këtij të fundit, parashtruesin e

kërkesës dhe vëllain e tij S. B. Sipas dosjes së lëndës, procedura gjyqësore përkitazi me këtë lëndë u vazhdua nga parashtruesi i kërkesës dhe disa paditës tjerë. Gjykata Themelore, më 22 mars 2017 e njoftoi parashtruesin e kërkesës, se seanca e caktuar për datën 27 mars 2017, nuk do të mbahet për arsye të angazhimit të gjyqtarëve në një punëtori. Përfundimisht, Gjykata Themelore, më 22 qershor 2023, mbajti seancën e shqyrtimit përgatitor, megjithatë edhe kjo seancë kishte dështuar me arsyetimin se *"[...] ndërhyrësit juridik L. B. dhe S.B., për të cilën Gjykata nuk ka prova se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt"*. Sipas informatave të pranuara nga Gjykata Themelore, më 8 tetor 2024, rezulton se për çështjen civile në fjalë është caktuar seanca e shqyrtimit kryesor për datën 16 tetor 2024. Gjykata nuk ka informata përkitazi me zhvillimet në lidhje me këtë lëndë pas 8 tetorit 2024.

41. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se si rezultat i kohëzgjatjes së procedurave përkitazi me lëndën [C.nr.655/2006), atij i është shkelur e drejta për një vendim gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

42. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim brenda një afati të arsyeshëm

43. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton: *"Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]"*.

44. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se "*Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]"*.

45. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

46. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshinë por nuk kufizohet në rastet (i) KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha,* Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović,* Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana,* Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli",* Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) KI19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj,* Aktvendim për papranueshmëri, i 20 shkurtit 2018. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ, përfshirë rastet (i) *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) *Mikulić kundër Kroacisë,* nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) *Scordino kundër Italisë* (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x)

Mishgjoni kundër Shqipërisë, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.

47. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se (i) përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50; *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 74; *Comingersoll kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 24; dhe *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës KI06/21, cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe KI19/21, cituar më lart, paragrafi 82).

48. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së, *Surmeli kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 128; dhe rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65), të cilat në mënyrë të përmbledhur do të elaborohen në vijim.

49. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, në mënyrë të ngjashme rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 66-67 dhe rastet e GJEDNJ-së, *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

50. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 68; dhe *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura

ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70).

51. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor; gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmangë përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 71-73; dhe KI06/21, cituar më lart, para. 67).

52. Sa i përket (iv) rëndësisë së e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "*sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë*"; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull, rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 74; dhe KI06/21, cituar më lart, paragrafi 67).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

53. Lidhur me këtë, më 7 nëntor 1991, A. B. (babai i ndjerë i parashtruesit të kërkesës) kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale, për kompensimin e dëmit si pasojë e djegies dhe shkatërrimit të shtëpisë nga një zjarr që dyshohej se ishte shkaktuar si pasojë e një avarie elektrike. Padia ishte riaktivizuar pas vitit 2000. A.B., më 25 maj 2009, kishte dorëzuar një urgjencë në Gjykatën Komunale për caktimin e seancës kryesore, pasi kishte kaluar kohë nga inicimi i padisë pa ndonjë seancë të mbajtur. Më 30 tetor 2013, pasi që A.B. kishte ndërruar jetë në gusht 2010, Gjykata Themelore, me Aktvendimin [T.nr.166/2010] shpalli trashëgimtarë legjitim të këtij të fundit, parashtruesin e kërkesës dhe vëllain e tij S. B. Prandaj, pavarësisht se rasti ishte iniciuar përmes padisë në vitin 1991, dhe më pas ishte riaktivizuar pas vitit 2000, i njëjti ishte duke pritur të zgjidhet nga gjykata e shkalle së parë, deri më 8 tetor 2024, kur Gjykata ishte informuar përkitazi me këtë rast.

54. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës është riaktivizuar pas vitit 2000, dhe ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershori 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, deri më 8 tetor 2024, duke përfshinë periudhën më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite. Rrjedhimisht, kjo është periudha që do të merret parasysh nga Gjykata.

55. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

56. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së çështjes, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se në rastin konkret ka pasur edhe procedura të ndërmjetme, siç është ajo e përcaktimit të trashëgimtarëve dhe e ndërmjetësve juridikë, të cilat në fazën fillestare kanë ndikuar në vonesën e gjykatës së shkallës së parë për zgjidhjen e lëndës civile [C. nr. 655/2006]. Për më tepër, Gjykata vlerëson se çështjet që ndërlidhen me kërkesa për kompensim dëmi për nga natyra edhe mund të jenë komplekse në vetvete dhe jo të lehta për t'u zgjidhur, për shkak të ndikimit që shkaktojnë procedurat e ndërmjetme që kërkojnë dhe ekspertizë të posaçme nga ekspertë të jashtëm, e cila nuk mund të ofrohet nga gjykata përkatëse, siç është caktimi i vlerës së dëmit të shkaktuar trashëgimtarëve të paditësit me rastin e djegies dhe shkatërrimit të shtëpisë.

57. Megjithatë, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë nuk kishte arritur ende në atë fazë, përderisa për çështjen në fjalë nuk ishte mbajtur asnjë seancë shqyrtuese, dhe se para se A.B. të ndërroj jetë, dhe pas përfundimit të procedurave trashëgimore në vitin 2013, kompleksitetit i lëndës nuk mund të justifikoj mosvendosjen e rastit deri në tetor të vitit 2024, nga Gjykata Themelore.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

58. Lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata vëren se A.B., babai i ndjerë i parashtruesit të kërkesës, po ashtu edhe parashtruesi i kërkesës ndërmorën çdo veprim procedural që u ishte kërkuar nga gjykata e shkallës së parë dhe legjislacioni në fuqi për zgjidhjen e lëndës civile në kohë të arsyeshme pa vonesa të tepruara. Gjykata, rikujton se padia në Gjykatën Komunale në Gjakovë, ishte parashtruar më 7 nëntor 1991, për të cilën janë zhvilluar gjithsej pesëmbëdhjetë (15) seanca, por pa një vendim përfundimtar. Çështja ishte riaktivizuar në vitin 2000 dhe që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës e deri në veprimin e fundit të ndërmarrë nga Gjykata Themelore, kanë kaluar më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite. Në këtë kontekst, Gjykata, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga babai i ndjerë i parashtruesit të kërkesës dhe vetë parashtruesi i kërkesës, vlerëson se palët në procedurë ishin të vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe se të njëjtit nuk kishin përdorur mënyra për të shtyrë procedurën. Gjithashtu, procedurat e nevojshme trashëgimore ishin përfunduar po ashtu qysh në vitin 2013.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

59. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, përkatësisht të gjykatës së shkallës së parë, thekson se kjo instancë gjyqësore, që nga inicimi i padisë, më pas aktivizimi i saj pas vitit 2000 nuk kishte marr asnjë vendim meritor për çështjen, madje nuk kishte arritur të caktonte as seancë shqyrtuese për t'iu dhënë palëve mundësinë e dëgjimit. Për pasojë, Gjykata rikujton se vonesat në zgjidhjen e çështjes kanë sjellë deri tek ndërmarrja e procedurave të ndërmjetme, siç është ajo e trashëgimisë pas vdekjes së A.B., babait të parashtruesit të kërkesës, në gusht të vitit 2010, e cila u vendos me Aktvendimin [T. nr. 166/2010] e 30 tetorit 2013 të Gjykatës Themelore.

60. Pas kësaj faze, Gjykata Themelore, më 22 mars 2017 kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës se seanca shqyrtuese, e caktuar më 27 mars 2017 nuk do të mbahej, për arsye të organizimit të një punëtorie dhe se gjyqtari i çështjes ishte i zënë me lëndë tjera të

caktuara më parë, gjë që nuk mund të justifikoj shtyrjen e një seance shqyrtuese. Gjykata Themelore, pas këtij veprimi, më 22 qershor 2023 caktoi për herë të parë seancë përgatitore, por edhe kjo seancë ishte anuluar me arsyetimin se në seancë morën pjesë ndërhyrësit juridik L. B. dhe S. B., duke theksuar se nuk kishte prova se të njëjtit ishin ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata, duke e shtyrë mbajtjen e saj më 17 korrik 2023. Për më tepër, Gjykata pas sigurimit të dosjes së lëndës nga Gjykata Themelore, vëren se seanca e radhës për rastin në fjalë ishte caktuar të mbahej për datën 16 tetor 2024.

61. Duke pasur parasysh të lartcekurat, si dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata thekson se përgjegjësia për zvarritjen e lëndës nuk mund t'i atribuohet në këtë rast sjelljes së paditësit dhe parashtruesit të kërkesës por Gjykatës Themelore, e cila pa ndonjë arsye konkrete nuk kishte arritur të caktojë as edhe një seancë përgatitore për t'u dhënë mundësi palëve për t'u deklaruar lidhur me kërkesëpadinë e tyre. Thënë këtë, dhe duke marrë për bazë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore si rezultat i mos caktimit të seancave apo mosmbajtjes së seancës përgatitore apo edhe shtyrjeve të seancave si pasojë e organizmit të punëtorive, ose mos thirrjes në mënyrë të rregullt të ndërhyrësve në procedurë, kontribuoi në zvarritjen e vendimmarrjes për këtë çështje, që përfshin periudhën kohore deri në tetor 2024, e cila periudhë ka rezultuar në tejzgjatje të procedurës pranë Gjykatës Themelore për mbi gjashtëmbëdhjetë (16) vite.

(iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor

62. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Çështja e parashtruesit të kërkesës, jo domosdoshmërisht hyn në atë kategori.

63. Thënë këtë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë kohore për zgjidhjen e një rasti të tillë pranë Gjykatës Themelore, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë, është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

64. Si përfundim, Gjykata marrë parasysh aplikimin kumulativ të kritereve të lartcekura, konstaton se (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest të kompensimit, nuk rezulton të jetë i një natyre aq të ndërlikuar sa që do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e kontestit përkatës të mos përfundojë as për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij, por vetëm ka ndjekur hapat procedural për realizimin e të drejtës së tij për kompensim lidhur me pronën e kontestuar; ndërsa (iii) Gjykata Themelore, as pas më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vite, nuk kanë zgjidhur rastin e tij, pasi i njëjti ende pret për t'u zgjidhur nga Gjykata Themelore, si instancë e parë gjyqësore.

65. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore ka shkelur të drejtën e tij për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

66. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij Aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike të

parashtruesit të kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

Përkitazi me kërkesën për kompensim

67. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensoj parashtruesit të kërkesës shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro "*në emër të dhimbjeve shpirtërore*".

68. Lidhur me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNj-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lar, paragrafi 115; KI06/21, cituar më lart, paragrafi 84; dhe KI64/23, *cituar më lart*, paragrafi 104).

69. Gjykata përsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të "*shpërblimit të drejtë*", sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësoj një dëm jo material. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës KI113/21, parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; dhe KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 85.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 12 shkurt 2025, njëzëri:

VENDOS

I. TA SHPALLË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;

III. TA URDHËROJË Gjykatën Themelore në Gjakovë jo më larg se 19 maj 2025, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

V. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Jeton Bytyqi	Nexhmi Rexhepi